

Shpallje të Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Prishtinë, 22.03.2019 – Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës - (1 vende pune)

Emri i Institucionit: Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës

Titulli i vendit të punës: Zyrtar Ligjor

Numri i Referencës: AACK/ADM/BNJ/02/2019

Tarifa e shërbimit: 875.00 (Bruto)

Raporton te: Drejtori i përgjithshëm

Lloji i kontratës: Marrëveshje për Shërbime të Veçanta - (MSHV)

Kohëzgjatja e kontratës: Me afat 6 mujor, me orar të plotë

Orari i punës: I plotë, 40 orë në javë

Lokacioni: Prishtinë, Arbëri "Rruga Ahmet Krasniqi" Nr.208, 10000

Qëllimi i vendit të punës Ofrimi i shërbimeve dhe këshillave profesionale në fushën e hartimit të politikave dhe legjislacionit në Autoritetin e Aviacionit Civil.

Detyrat kryesore:

1. Harton akte normative si dhe aktet tjera juridike të cilat dalin nga fushë veprimtaria e institucionit në bazë të procedurave të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi;
2. Siguron përputhshmërinë e projektligjeve dhe akteve tjera nënligjore me legjislacionin në fuqi në Kosovë;

3. Kujdeset që përmbajtja dhe forma e aktit normativ të është sa më e saktë, si nga aspekti gjuhësor dhe teknik si dhe të jenë identike në të tri gjuhët zyrtare;
4. Bën hulumtime dhe analiza të informatave në temat e caktuara nga mbikëqyrësi dhe identifikon opsionet ose çështjet për shqyrtim.
5. Sipas kërkesës dhe sipas udhëzimeve të nivelit më të lartë jep opinione ligjore si dhe bën hartimin e projektmarrëveshjeve, projektvendimeve dhe projekt akteve të tjera;
6. Bashkëpunon dhe komunikon me njësitë tjera brenda dhe jashtë institucionit për aktivitetet që ndërlidhen me fushën e legjislacionit;
7. Ofron këshilla ligjore, rekomandime, udhëzime dhe opinione për drejtorin e përgjithshëm brenda kompetencave të AAC-së sipas ligjit;
8. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Diplomë universitare Fakulteti juridik, minimum 2 vite përvojë pune në fushën përkatëse
- Njohuri të thellë dhe të specializuar në fushën e legjislacionit dhe hartimin e akteve ligjore;
- Përvojë në përfaqësim të palëve
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës koordinimi eventual i personelit në nivel administrativ;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
- Njohuri të mira të gjuhës angleze dhe serbe.

Autoriteti i Aviacionit Civil mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, nga të gjitha komunitetet.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, të kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkojnë për pozitën përkatëse.

Data e mbylljes së konkursit

Konkursi është i hapur shtat (7) ditë nga data 22.03.2019 deri më 28.03.2019 shpalljes në gazeta të përditshme kosovare dhe në faqen zyrtare të AACK-së në internet. Data e fundit për aplikim është 28.03.2019 deri në ora 16:00, të gjitha aplikacionet e kompletuara, të dërguara deri më këtë datë, do të konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave:

Formularët e aplikimit mund të merren nga faqja zyrtare e AACK-së në internet, në

<http://caa-ks.org/category/lajme/> ose në selinë e AACK-së, Rr. Ahmet Krasniqi Nr.208, Lagjja Arbëria, 10000 Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në orën 16:00, deri në ditën e fundit për konkurim.

Aplikacionet dhe kopjet e dokumenteve që dëshmojnë për kualifikimet personale mund të dorëzohen nëpërmes postës elektronike në e-adresën: Safete.Selmani@caa-ks.org ose në adresën postare të cekur më lart, me shënimin "Për rekrutim - pozita në të cilën konkuroni". Dokumentet e pranuar nuk do të kthehen. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Për informata plotësuese mund të kontaktoni në numrin 038 248 629 lok. 106.

Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, ashtu siç specifikohet në nenin 11 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.